



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
SEKTORI I PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot.

Patos, më 24/05/2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM
(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)
OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje bazë materiale ndërtimore për rrethimin e stadiumit
“Alush Noga”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Materiale ndertimi dhe produkte ndihmese per ndertimin kodi 44.

VLERA E FONDIT LIMIT: 4,352,493 (katër milion e treqind e pesëdhjetë e dy mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga Të ardhurat lokale 2023, për objektin “Blerje bazë materiale ndërtimore për rrethimin e stadiumit “Alush Noga”.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Patos** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **1,740,997.2 (një milion e shtatëqind e dyzetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë pikë dy) lekë.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

4,352,493 x 40% = 1,740,997.2 (një milion e shtatëqind e dyzetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë pikë dy) lekë.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.2 Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2022.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-se).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi fitues përpara dhënies së kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit

publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore per vitin 2020 sipas kësteve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e

aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se ... % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

4,352,493 x 20% = 870,497 (tetëqind e shtatedhjetë mijë e katerqind e nentedhjetë e shtatë) Lekë.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.3. Operatorët Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesin një vetëdeklarim nëpërmjet të cilit deklarojnë se marrin përsipër furnizimin e mallit në destinacionin e kërkuar dhe brenda afatit të levrimit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor.

ARGUMENTIM: Në bazë, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të pikës 8 të nenit 40 VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar . Ky vetëdeklarim kërkohet për ti vertetuar dhe garantuar AK-së realizimin me sukses te procedures, përsa i përket dorëzimit të mallrave objekt prokurimi. Nuk është kërkuar qe OE të kenë detyrimisht një mjet transporti ose të lidhin kontrata qeraje për mjetet por mund ta zgjidhin në cfarëdolloj mënyre alternative për realizimin e kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.**

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimet për bazen materiale te kerkuar

- **Zhavor lumi** **sasia e kerkuar** **70 m3**

Zhavorri I lumit I cili do te perdoret per strukturat b/a do te jete perzierje e zallit dhe e reres e marre direct ne lume por e paster nga mbetjet e baltes apo papasterit te tjera. Fraksioni dhe raporti I kerkuar I perberesve te tij do jo me I madh se 50 mm dhe raporti 40% rere x60 % zall.

Operatori ekonomik ofertues do te marre zallin e lare nga ata prodhues qe mund te sigurojne cilesi te mire, perputhshmeri me llojin e duhur dhe vazhdimesine ne furnizim. Keshtu, me fillimin e punimeve/furnizimit Operatori ekonomik fitues duhet te paraqese se bashku me sasine e mallit edhe certifikaten e cilesise se ketij malli qe po dorrezohet.

- **Rere e lare** **sasia e kerkuar** **100 m3**

Rera e lare e cili do te perdoret per strukturat b/a do te jete rere e prodhuar ne lavatrice nga materiale lavatriceje te paster nga mbetjet e baltes apo papasterit te tjera. Fraksioni I kerkuar do te jete jo me I madh se 5 mm. Operatori ekonomik ofertues do te marre zallin e lare nga ata prodhues qe mund te sigurojne cilesi te mire, perputhshmeri me llojin e duhur dhe vazhdimesine

ne furnizim. Keshtu, me fillimin e punimeve/furnizimit Operatori ekonomik fitues duhet te paraqese se bashku me sasine e mallit edhe certifikaten e cilesise se ketij malli qe po dorrezohet

- **Zall lavatriceje** **sasia e kerkuar** **100 m3**

Zalli I lare I cili do te perdoret per strukturat b/a do te jete zall I prodhuar ne lavatrice nga gure lavatriceje te paster nga mbetjet e baltes apo papasterit te tjera. Fraksioni I kerkuar do te jete jo me I vogel se 5 mm dhe jo me I madh se 25 mm.

Operatori ekonomik ofertues do te marre zallin e lare nga ata prodhues qe mund te sigurojne cilesi te mire, perputhshmeri me llojin e duhur dhe vazhdimesine ne furnizim. Keshtu, me fillimin e punimeve/furnizimit Operatori ekonomik fitues duhet te paraqese se bashku me sasine e mallit edhe certifikaten e cilesise se ketij malli qe po dorrezohet.

- **Çimentoja R32.5N** **sasia e kerkuar** **550 kv**

Çimentoja qe do te perdoret per pergatitjen e betonit duhet te plotesoje kerkesat e dispozitave ne fuqi te Standarteve Nderkombetare te Punimeve Civile.

Operatori ekonomik ofertues do te marre çimenton nga ata prodhues qe mund te sigurojne cilesi te mire, perputhshmeri me llojin e duhur dhe vazhdimesine ne furnizim. Keshtu, me fillimin e punimeve/furnizimit Operatori ekonomik fitues duhet te paraqese se bashku me sasine e mallit edhe certifikaten e cilesise se ketij malli qe po dorrezohet.

- **Hekur betoni $\emptyset < 10\text{mm}$** **sasia e kerkuar** **7'755 kg.**

Hekuri qe do te perdoren per ndertimin e mureve b/a do te jene me gjatesi $l=12$ ml ne perputhej me standartet per prodhimin edhe tregetimin e tij. Klasa e hekurit te perdorur do te jete Feb Çeliku per armimin e betonit (beton i armuar dhe i paranderur) duhet te perputhet me tipet dhe karakteristikat e vendosura Vendimi i Ministrise se Puneve Publike Italiane i dates 14.02.1992. Specifikimet Teknike per Kryerjen e Punimeve ne Beton Normal dhe te Armuar e te Paranderur dhe per Strukturat e Çelikut”.

Kampionet e testimit per shufra çeliku te thjeshta dhe te kthyera perfaqesohet me nje sasi prej 25 ton

maksimumi. Çdo lot prej me pak se 25 ton do te konsiderohet si nje kampion i pavarur.

Kampioni test i aprovuar per çelikon e betonit te paranderur perfaqesohet me nje njesi ngarkese prej 30

ton maksimumi, e transportuar si nje dergese e vetme dhe qe perbehet nga produkte me elemente nominal homogjene (nga pikepamja e dimensionit, mekanike dhe formuese).

Prodhuei duhet te shenoje te gjitha materialet e çelikut ne menyre qe te garantoje identifikimin e Fabrikes, klasifikimin e çelikut dhe kapacitetin e tij ne perkulje.

Kampioni dhe testimi i çelikut duhet të jete konform standarteve të mëposhtme:

1. Kampionizimi dhe testimi i çelikut për armim UNI 564-1960 dhe 6407-1969.

2. Karakteristikat mekanike:

Shufra – EN 10002/1x-1994.

Tela për parandëje - UNI – 5292-1979.

Kavot dhe mekanizmat paratensionimit – UNI – 3171 - 1985.

Rezistenca në lodhje – UNI – 3964 – 1985.

Prodhuesi do të shoqërojë çdo dergesë me çertifikatë kualifikimi dhe verifikimi të prodhimit të nxjerra nga laboratorit zyrtar të vendit të origjinës.

Në kanton, Supervizori në marrëveshje me Kontraktorin do të marrë kampione për çdo tip çeliku për t'i dërguar në laboratorin zyrtar për kontrollin e karakteristikave të deklaruara nga prodhuesi.

Teste të caktuara mund të bëhen direkt në kanton.

Operatori ekonomik ofertues do të marrë hekurin nga ata prodhues që mund të sigurojnë cilësi të mirë, përputhshmeri me llojin e duhur dhe vazhdimësi në furnizim. Kështu, me fillimin e punimeve/furnizimit Operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë së bashku me sasinë e mallit edhe certifikatën e cilësisë së këtij malli që po dorëzohet.

- **Hekur betoni $\varnothing > 10\text{mm}$ sasia e kërkuar 23'445 kg.**

Shufrat e armimit duhet të kthehen sipas masave dhe dimensioneve të vizatimeve, dhe në përputhje të plote me rregulloren e, rishikuar së fundi të ASTM, shënimi A-615 me titullin "Specifikimet për shufrat e hekurit për betonarme". Ato duhet të perkulen në përputhje me vizatimet e ASTM A-305, Çelik 3 me sigma të rrjedhshmerisë 250 kg/cm².

Hekuri i armimit duhet të jete pa njolla, ndryshk, mbeturina të mullijve, bojera, vajra, graso, dhe raste ngjitese ose ndonjë material tjetër që mund të demtojë lidhjen midis betonit dhe armimit ose që mund të shkaktojë korrozion të armimit ose shperberje të betonit. Çimento për suva nuk duhet të lejohet. As madhësia dhe as gjatësia e shufrave nuk duhet të jete me pak se madhësia ose gjatësia e treguar në vizatime.

Shufrat duhet të perkulen gjithmone në të ftohtë. Shufrat e perkulura jo sic duhet do të perdoren vetëm në se mjetet e perdorura për drejtimin dhe riperkuljen të jete të tilla që të mos demtojë materialin. Asnjë armim nuk do të perkulet në pozita pune pa aprovimin e Mbikqyresit të Punimeve, në se është ngulur në betonin e forcuar. Rrezja e brendshme e perkuljeve nuk

duhet te jete me e vogel se dyfishi i diametrit te shufrave per hekur te bute dhe trefishi i diametrit te shufres per hekur shume elastik.

Armimi duhet te behet me shume kujdes dhe te mbahet nga paisjet e miratuara ne pozicionin e paraqitura ne skica. Shufrat qe jane parashikuar te jene ne kontakt duhet te lidhen se bashku me siguri te larte ne te gjitha pikat e kryqezimit me tel te kalitur hekuri te bute me diameter.No.16. Kordonat lidhes dhe te tjeret si keto duhet te lidhen fort me shufrat me te cilat jane parashikuar te jene ne kontakt dhe pervec kesaj duhet te lidhen ne menyre te sigurte me tel. Menjehere para betonimit, armimi duhet te kontrollohet per saktesi vendosjeje dhe pastertie dhe do te korigjohet ne se eshte e nevojshme.

Spesoret duhet te jene prej llaci me cemento dhe rere 1:2 ose materiale te tjera te miratuara nga Mbikqyresi i Punimeve.

Sipermarresi duhet te pershtase masa efektive per te siguruar qe perforcimi te qendroje i palevizur gjate forcimit te mases se hedhur dhe vendosjes se betonit.

Ne soletat e dhena me dy ose me shume shtresa perforcimi, shtresat paralele te hekurit duhet te mbeshteten ne pozicion me ndihmen e mbajteseve prej hekuri. Spesoret vendosen ne cdo mbajtese per te mbeshtetur shtresat e armimit nga forcimi ose armatura.

Pervec se kur tregohet ndryshe ne skica, gjatesia e nyjeve bashkuese duhet te jete jo me pak se 40 here e diametrit te shufres me diameter me te madh.

Armimet e ndertuara kur shtrohen perbri seksioneve te tjera te armimit ose kur xhuntohen, duhet te kene nje minimum xhuntimi prej 300mm per shufrat kryesore dhe 150 mm per shufrat e terthorta. Perdorimi i mbeturinave te prera nuk do te lejohet.

Pervec se kur eshte specifiuar apo treguar ndryshe ne skica, mbulimi i betonit ne perforcimin me te afert duke perjashtuar suvane ose punime te tjera dekorative dhe forcim betoni, do te jete si me poshte:

Per pune te jashtme dhe per pune ne sipërfaqe toke dhe ne struktura ujembajtese -50mm

Per pune te brendeshme ne struktura joubajjtese:

per trare dhe kolona-50mm ne hekurin kryesor dhe ne asnje vend me pak se 40mm ne shufren me afer murit te jashtem

per forcimin e soletave-25mm per te gjitha shufrat ose diametri i shufres me te madhe, ciladoqofte me e madhja.

Prerja, perkulja dhe vendosja e armimit do te jete pjese e punes brenda cmimit njesi te vendosura ne Oferten e tenderit per armimin e hekurit te furnizuar dhe te vene ne pune.

Projektimi i armimit nga puna qe eshte duke u realizuar ose e realizuar tashme, nuk do te kthehet ne pozicionin e sakte vetem ne rast se eshte miratuar nga Mbikqyresi i Punimeve dhe do te mbrohet nga deformimi ose demtime te tjera. Saldimi i shufrave te perforcuara me perjashtim te rasteve te shufrave te fabrikua me saldim nuk do te lejohet. Shufrat e perforcuara te ekspozuara per shtesa te ardhshme, do te mbrohen nga korrozioni dhe rreziqe te tjera.

- **Tel bari** **sasia e kerkuar** **165.76 kg**

Materiali I telit tebarit do te sherbeje per lidhjen e shufrave te hekurit ne formen e percaktuar ne project. Permasat e materialet te kerkuar do te jene $d=1.2\text{mm}$ dhe do te jete I ndare ne njesi me peshe 20 kg/ruloni. Materiali I kerkuar: metalik, ngjyra e kerkuar: gri .

Operatori ekonomik ofertues do te marre materialin e telit te barit nga ata prodhues dhe/ose shites qe mund te sigurojne cilesi te mire, perputhshmeri me llojin e duhur dhe vazhdimesine ne furnizim. Keshtu, me fillimin e punimeve/furnizimit Operatori ekonomik fitues duhet te paraqese se bashku me sasine e mallit edhe certifikaten e cilesise se ketij malli qe po dorrezohet.

- **Stuko patinimi** **sasia e kerkuar** **2'601.511 kg**

STUko patinimi është stuko çimentoje jashtëzakonisht kokërrimët, me përmbajtje rrëshire, për përdorim të jashtëm ose të brendshëm. Duke shtuar ujë krijohet një masë në trajtë paste me punueshmëri shumë të mirë, e përshtatshme për patinim. Për arsye të përbërjes së tij kokometrike mund të aplikohet edhe me pompë.

Operatori ekonomik ofertues do te marre materialin e stukos per patimin nga ata prodhues dhe/ose shites qe mund te sigurojne cilesi te mire, perputhshmeri me llojin e duhur dhe vazhdimesine ne furnizim. Keshtu, me fillimin e punimeve/furnizimit Operatori ekonomik fitues duhet te paraqese se bashku me sasine e mallit edhe certifikaten e cilesise se ketij malli qe po dorrezohet.

- **Grafiato e gatshme** **sasia e kerkuar** **10'000.08 kg**

Boja grafiato e gatshme eshte materiali qe do te aplikohet ne siperfaqen perfundimtare te elementeve apo kollonave ne objektin qe do te ndertohet. Perbaerja e saj eshte me baze boje dhe te pasuruara me reshirera te cilat bejne te mundur krijimin e nje siperfaqe te njetrajtshme dhe rezistence ndaj agjenteve atmosferike per

Eshte veshje dekorative për ambiente të jashtme dhe të brëndshme me bazë çimento të bardhë. Material eshte në formë pluhuri i përbërë nga rërë mermeri të cilësisë së lartë, aditivë special, agjentë hidrofobikë dhe gëlqere të hidratuar. Karakterizohet nga një punueshmëri shumë e mire, kohe e gjatë pune, aplikim i shpejtë duke krijuar një strukturë të bukur dhe të njëtrajtshme. Materiali grafiato duhet te ndërtoje një kapilaritet të lartë të bazamentit duke garantuar që lagështira të dalë nga muri. Si rezultat krijohet një ambjent mjaft komod brënda në shtëpi, duke pasur freski në kohën e verës dhe ngrohtësi në dimer. Është e rekomandueshme që

shtresa e grafiatos të lyhet me bojë. Ofron rezistencë të lartë ndaj kushteve atmosferike, bëjnë difuzion të mirë të avujve dhe kanë veti kundra lagështirës.

Operatori ekonomik ofertues do të marrë materialin e grafiatos se gatshme nga ata prodhues dhe/ose shites që mund të sigurojnë cilësi të mire, përputhshmeri me llojin e duhur dhe vazhdimësinë në furnizim. Kështu, me fillimin e punimeve/furnizimit Operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë së bashku me sasine e mallit edhe certifikatën e cilësisë së këtij malli që po dorëzohet.

- **Boje hidroplastike importit cilësia e I 580.16 kg**

Bojë hidroplastike - akrilike duhet të jetë me cilësi të lartë për përdorim të jashtëm. Boja hidroplastike – akrilike duhet të karakterizohet për rezistencën e lartë ndaj ujit, mbulimin e përkryer të sipërfaqes dhe jetëgjatësinë ndaj kushtet e vështira të motit dhe vjetërsimit. Ajo duhet të jetë e depërtueshme nga avulli duke lejuar ndërtesën/ strukturën të marrë frymë. Duhet të ofrojë ngjytje të forta në çdo lloj nënshtrese, të vjetër ose të re si suva, beton, dru, etj. Duhet të ketë punueshmëri të shkëlqyer dhe thahet shpejt. Ajo duhet të krijojë një sipërfaqe përfundimtare me një rezultat të përkryer mat.

Operatori ekonomik ofertues do të marrë materialin e bojës hidroplastike - akrilike për përdorim të jashtëm nga ata prodhues dhe/ose shites që mund të sigurojnë cilësi të mire, përputhshmeri me llojin e duhur dhe vazhdimësinë në furnizim. Kështu, me fillimin e punimeve/furnizimit Operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë së bashku me sasine e mallit edhe certifikatën e cilësisë së këtij malli që po dorëzohet.

- **Lende e sharuar druri sasia e kerkuar 5.5 m3**

Lenda e derrases duhet të jetë e stazhionuar dhe tipi pishe. Gjatesia e lendes së derrases duhet të jetë 3-4 m. Trashësia e kerkuar e kësaj lende druri duhet të jetë 2.5 cm me shmangie të vogla jo më shumë se 5% e trashësisë së saj. Lageshtira e lendes së derrases duhet të jetë jo më shumë se 15 %.

Operatori ekonomik ofertues do të marrë lenden e derrases nga ata prodhues që mund të sigurojnë cilësi të mire, përputhshmeri me llojin e duhur dhe vazhdimësinë në furnizim. Kështu, me fillimin e punimeve/furnizimit Operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë së bashku me sasine e mallit edhe certifikatën e cilësisë së këtij malli që po dorëzohet.

- **Lende drurir e sharuar (Betoforma) 1.2 m3**

Betoformat e betonit janë panele të gatshme me material druri të presuar dhe me shtresa të vendosura në drejtime të ndryshme me shtresën paraardhëse. Gjeresia e places së betoformës duhet të jetë jo më shumë se 40 cm. trashësia e betoformës duhet të jetë jo më shumë se 20 mm. gjatesia e betoformave duhet të jetë jo më shumë se 200 cm.

Operatori ekonomik ofertues do të marrë lenden e derrases (betoformat) nga ata prodhues/ shites që mund të sigurojnë cilësi të mire, përputhshmeri me llojin e duhur dhe

vazhdimesine ne furnizim. Keshtu, me fillimin e punimeve/furnizimit Operatori ekonomik fitues duhet te paraqese se bashku me sasine e mallit edhe certifikaten e cilesise se ketij malli qe po dorrezohet.

- **Gozhde Nr 7 (t=70 mm) sasai e kerkuar 200 kg**

Gozhdet qe do te perdoren do te jene me gjatesi l=70mm ne perputhej me standartet per prodhimin edhe tregetimin e tyre.

Operatori ekonomik ofertues do te marre gozhdet nga ata prodhues qe mund te sigurojne cilesi te mire, perputhshmeri me llojin e duhur dhe vazhdimesine ne furnizim. Keshtu, me fillimin e punimeve/furnizimit Operatori ekonomik fitues duhet te paraqese se bashku me sasine e mallit edhe certifikaten e cilesise se ketij malli qe po dorrezohet.

Specifikimet teknike jane të Hartuara nga DREJTORIA E HARTIMIT TE PROJEKTEVE, SHERBIMEVE DHE EMERGJENCAVE CIVILE jane bazuar në nevojat e Autoritetit Kontraktor bazuar në pikën 2 neni 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar për të siguruar mallra cilësor e të përshtatshëm për realizimin me sukses te kontrates.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimitisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën **05/06/2023, ora 11:00.**

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje bazë materiale grumbullimin e mbetjeve urbane:.

Bashkëlidhur këtij procesverbali:

Dokumentat e tenderit.

NJESIA E PROKURIMIT

Florian **Kita**

Arben **Manoku**

Mitjon **Nikolla**